



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:259195  
Datë: 28.06.2024  
Numri i dokumentit: 05874703

KPPP.nr.2010/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “BEGHLER TALO” Sh.P.K., me seli në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, me NUI: 811866948, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Liman Musa me seli të zyrës në Ferizaj, kundër debitorit “BEGHLER” L.L.C, me seli në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, me NUI: 810974081, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson zyra e avokatisë “THEMIS” Sh.P.K., me seli në Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.368/23 të datës 31.10.2023 të Përbaruesit Privat Argjent Xheladini me seli në Viti, jashtë seancës, me datë 26.06.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit debitorit “BEGHLER” L.L.C, ANULOHET urdhri përbarimor P.nr.368/23 i datës 31.10.2023, i Përbaruesit Privat Argjent Xheladini dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

**A r s y e t i m**

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “BEGHLER TALO” Sh.P.K., ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr.368/23 të datës 31.10.2023, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr.249 të datës 13.12.2022, me të

cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e lejimit të këtij urdhri-pranimi të tij, t'i paguaj kreditorit shumën prej 108,175.59 Euro, me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përbarimor për faktin se i njëjti është marr në kundërshtim me nenin 71 pika 1.1 të LPP-së, ngase detyrimi i përcaktuar dhe i lejuar me propozim nuk ekziston dhe nuk është bërë i arritshëm, ndërsa dokumentet me të cilat është lejuar përbarimi nuk përmbajnë tipare të përbarueshmërisë.

Më tej ka theksuar se dokumenti i besueshëm në të cilën mbështetet propozimi për përbarim nuk është faturë mbi shitjen e mallit me tiparet e saj juridike për të qenë dokument i besueshëm në një çështje përbarimore, pasi që edhe qarkullimi i mallrave nuk është bërë, dhe poashtu në të nuk janë të dhënat e kreditorit dhe debitorit, nuk është e paraparë koha e pagesës, dhe si e tillë nuk ka elemente të përbarueshmërisë. Dokumenti i cili i është bashkangjitur propozimit për përbarim paraqet vetëm regjistrimin e mallrave në mes të depos doganore të palëve në procedurë dhe jo qarkullim të rregullt mes subjekteve. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të lihet jashtë fuqisë urdhri i Përbaruesit Privat.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim si të pabazuara, për faktin se i njëjti nuk ka arritur t'i vërtetoj me asnjë provë materiale, ngase qëllimi i vetëm i debitorit është vonesa dhe shtyrja e përbarimit. Më tej ka theksuar se në bazë të dokumentit të besueshëm (faturave) debitori ka qenë i obliguar që t'i paguaj kreditorit shumën prej 108,175.59 Euro, ku poashtu konstatohet-konfirmohet pranimi i mallit të përshkruar në faturat origjinale përmes nënshkrimit dhe vulosjes nga debitori i cili konfirmon pranimin e mallit pa kurrfarë vërejtje, dhe po ashtu vlen të ceket se ky mall është shitur me faturën nr.244 të datës 20.12.2022. Ka shtuar se malli ka dalur nga depo doganore dhe është zhdoganuar përmes DUD R88514 e datës 20.12.2023 në ZBD Prishtinë (ku është specifikuar edhe numri i faturës me datë tek shifra 380 e cila simbolizon faturën 249 dt.20.12.2022, me valutën e njëjtë dhe përshkrimin e mallit të njëjtë). Kjo shitblerje është bërë konform kontratës për shitje të produkteve elektrike e datës 10.12.2022, dhe debitori ka dhënë deklaratë me shkrim për arritshmërinë e borxhit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa të vërtetohet urdhri për përbarim, dhe në rast se debitori ushtron

ankesë ndaj aktvendimit të gjykatës të obligohet ta deponoj shumën në lartësi të borxhit në emër të garancisë për ankesë. I ka kërkuar edhe shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 550 Euro sipas TOAK-së, konkretisht neni 9 lidhur me nenin 6.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Fatura nr.249 e datës 13.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa dokumenti i besueshëm, sipas nën par.1.3 janë edhe faturat. Më tutje, me nenin 29 par.3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura nr.249 e datës 13.12.2022, i emërtuar si *“Daljet nga depoja doganore-Re Export (EXP)”*, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LPP-së, nuk është i përshtatshëm për përmbartim, ngase dokumenti i emërtuar si *“Daljet nga depoja doganore-Re Export (EXP)”* nuk është përcaktuar si dokument i besueshëm konform nenit 29 par.1 nën par.1.3 të LPP-së.

Për më tepër, bazuar në nenin 29 par.3 të LPP-së, është përcaktuar se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, mirëpo në rastin konkret në

dokumentin me anë të të cilit është lejuar urdhri përmbartimor, nuk është treguar kreditori dhe debitori si dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, dhe nga kjo rezulton se dokumenti i tillë nuk përmban as tipare të përmbartueshmërisë.

Andaj duke marr parasysh faktin se në rastin konkret dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë, si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbartuesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor, i emërtuar si “Daljet nga depoja doganore-Re Export (EXP)”, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka

tipare të përmbartueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2010/23 datë 26.06.2024

Gjyqtari,  
Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.